

Salzburg, Mars 2013

Testimi standard në matematikë klasa e 4.

Projekti pilot në gjuhën gjermane “Aftësia për të folur dhe për të diskutuar me njëri-tjetrin”

Të nderuara nëna, baballarë dhe edukatorë!

Si prindër Ju me siguri jeni të interesuar nëse fëmija Juaj do të jetë i pajisur me të gjitha njohuritë e përcaktuara si të nevojshme në fund të shkollës fillore përsa i përket lëndës së matematikës. Këto teste standarde organizohen pikërisht për të zbuluar se deri në çfarë mase është arritur ky qëllim në secilën shkollë por edhe përsa i përket sistemit arsimor në përgjithësi. Në vitin shkollor 2012/13 do të organizohet për herë të parë testimi **i standardit arsimor në lëndën e matematikës**. Do të testohen të gjithë nxënësit/et e klasës së 4-të në të gjithë Austrinë qofshin ata në shkolla publike apo private të sanksionuara me ligj. Në 26 shkolla të përzgjedhura në mënyrë rastësore do të kryet një projekt pilot (provë) i cili realizohet në vazhden e përgatitjeve për testin standard në lëndën e gjuhës gjermane i cili do të organizohet në vitin 2014. Ky projekt pilot do të testojë kompetencat e të folurit dhe aftësisë për të diskutuar me njëri-tjetrin. Qëllimi i këtij testimi është vënia në provë e detyrave të reja që janë zhvilluar si dhe testimi i procedurave. Klasa në të cilën ndodhet fëmija Juaj është përzgjedhur për të marrë pjesë në këtë **projekt pilot në lëndën e gjuhës gjermane “Aftësia për të folur dhe për të diskutuar me njëri-tjetrin”**. Në këtë projekt pilot nuk do të marrin pjesë të gjithë nxënësit (numri maksimal është 24 nxënës përfshirë edhe nxënësit zëvendësues). Mësuesi i klasës do të informojë fëmijën Tuaj nëse ai është zgjedhur për të marrë pjesë në këtë projekt.

Bazat ligjore

Përfshirja e nxënësve në studime të tilla që lidhen me standardet e arsimit është e detyrueshme, kjo bazuar në ligjin BIFIE (BGBl. I Nr. 25/2008, § 6 Paragrafi. 2 idF BGBl. I Nr. 113/2009 idF BGBl. I Nr. 7/2013). Të gjitha të dhënat personale të nxënësve do të mblidhen në mënyrë indirekte për secilin prej tyre. Të gjithë punonjësit e institutit BIFIE janë të detyruar të zbatojnë ligjin BIFIE (BGBl. I Nr. 25/2008, § 3 Paragrafi 2 idF BGBl. I Nr. 113/2009. I Nr. 7/2013) mbi ruajtjen e fshehtësisë e këtyre të dhënave.

Datat e testeve

Testimi standard në matematikë do të organizohet në datat e mëposhtme:

Data e provimit: E Martë, 28. Maj 2013 ose data alternative: e mërkurë, 05. Qershor 2013

Dita e testimit për projektin pilot në gjuhën gjermane “Aftësia për të folur dhe për të diskutuar me njëri-tjetrin” do të përcaktohet në mënyrë individuale midis drejtorisë së shkollës dhe institucionit që kryen këto teste. Ky testim do të kryhet në këtë hapësirë kohore:

Hapësira kohore nga e marta më 08. Prill deri të premten më 26 Prill 2013.

Informacione të tjera mbi testin

Testimi standard në matematikë do të organizohet gjatë një ore normale mësimore. Do të fillojë me orën e parë të mësimin dhe do të zgjasë rreth 3 orë duke përfshirë këtu sqarimet e nevojshme dhe pushimet. Testimi do të jetë i organizuar si më poshtë:

Përhëndetja, sqarime dhe udhëzime të përgjithshme	Pjesa 1 e testimit	Pushimi	Pjesa 2 e testimit	Pushim	Pyetësori
rreth 10 minuta	40 minuta	15 minuta	40 minuta	10 minuta	20 minuta

Projekti pilot në lëndën e gjuhës gjermane “Aftësia për të folur dhe për të diskutuar me njëri-tjetrin”

gjithashtu do të kryhet gjatë orëve normale mësimore. Nxënësit e përzgjedhur do të jenë nga dy dhe do të kryejnë një bisedë e cila do të zgjasë rreth 20 minuta, dhe në të cilën do të ketë një fazë me karakter monologu dhe një fazë me karakter dialogu. Gjithashtu nxënësve do t’ju jepet një formular i shkurtër i cili duhet të plotësohet po atë ditë dhe duhet të silllet sërish në shkollë.

Pas përfundimit të testit do të vazhdojë mësimi sipas orarit ditor. Ju lutem i kujtoni vajzës/djalit Tuaj që ditën e testimit në matematikë të marrë me vete një **raportor**. Në ditën e testimit për projektin pilot në gjuhën gjermane “Aftësia për të folur dhe për të diskutuar me njëri-tjetrin” nxënësit nuk do të kenë nevojë për ndonjë element të posaçëm ndihmës.

Testi standard i matematikës do të administrohet nga mësuesit e shkollës të trajnuar posaçërisht për diçka të tillë. Në 7% të klasave që do të testohen, testi do të drejtohet nga një mësues/e e huaj e cila vjen atë ditë në shkollë dhe drejton testimin. Përgjithësisht këto mësues të huaj janë mësues të një shkolle tjetër.

Rezultati i marrë, i cili do të jetë gati nga fundi i semestrit të parë të vitit të ardhshëm arsimor, do të prodhojë informacion se deri në çmasë nxënësit kanë arritur të absorbojnë vërtetë kompetencat e synuara. Në ditën e testit nxënësit do të marrin një **kod personal**, me anë të së cilit ata mund të futen në internet dhe të marrin **rezultatet e testit të tyre**. Me këtë kod personal pajisen vetëm nxënësit. Në rastin kur ky kod humbet BIFIE nuk është në gjendje ta zëvendësojë atë. Për këtë arsye është e rëndësishme që nxënësit ta ruajnë mirë këtë kod ose tua besojnë Juve atë! Rezultatet e këtij testimi nuk janë pjesë e rezultateve shkollore të fëmijës Suaj – mësuesit nuk do të kenë mundësinë që tua komunikojnë nxënësve rezultatet e këtij testimi.

Ndryshe nga testimet standarde, **projekti pilot në lëndën e gjuhës gjermane “Aftësia për të folur dhe për të diskutuar me njëri-tjetrin” do të kryhen vetëm nga mësues të huaj**. Në shkollë do të vijnë dy mësues të huaj: Një person i cili do të kryejë bisedën me nxënësit dhe një person tjetër i cili do të bëjë vlerësimin. Duke qenë se bëhet fjalë për projekte pilote, **rezultatet** nuk bëhen të ditura.

Pyetësi i prindërve

Testit i bashkëngjitet **një pyetësor** për nxënësit, i cili njëkohësisht do të mbledhë informacione edhe për prindërit/edukatorët, stafin arsimor dhe drejtuesit e shkollës, informacione të cilat përfshijnë të dhëna mbi kushtet shkollore dhe jashtë shkollore të të mësuarit dhe të jetuarit. Pyetësorin e prindërve/edukatorëve do ta sjellë vajza/djali Juaj në shtëpi ditën kur do të organizohet edhe testimi. **Ju lutemi ta plotësoni këtë formular po atë ditë, ta vendosni në një zarf të mbyllur dhe t’ia jepni fëmijës Suaj ta sjellë në shkollë sa më parë të jetë e mundur**. Pyetësorët do të grumbullohen në shkollë dhe më pas do ti dërgohen BIFIE. Në rast nevojë, duke filluar nga muaji Maj, ju mund ti gjeni në BIFIE-Website (www.bifi.e.at/node/1829) pyetësorët e prindërve të përkthyer në gjuhën shqipe, boshnjake, angleze, në kroatisht, serbisht, hungarisht, sllovenisht dhe turqisht.


Dëshironi të dini më shumë mbi standardet e arsimimit?

Nëse keni dëshirë të informoheni mbi natyrën e detyrave të përfshira në këto testime atëherë në www.bifi.e.at/node/58 ju mund të gjeni shembuj detyrash për lëndë të ndryshme (për këtë klikoni në të djathtë në linkun “Njësi të publikuara”). Informacione të tjera mund të gjeni në fletëpalosjen bashkëngjitur ose në faqen tonë (www.bifi.e.at). Nëse keni pyetje të tjera ose nëse keni nevojë për ndihmë atëherë BIFIE ju mirëpret gjithmonë në këta numra telefoni:


Testimi: **Tel.: 0662/620088-3600; E-Mail: bist4@bifi.e.at**
Rezultatet: **Tel.: 0662/620088-3700; E-Mail: bist4-rm@bifi.e.at**

Gjithashtu ju mund t’i drejtoheni edhe institucioneve që përfaqësojnë shoqatat e prindërve. Në këtë rast ne Ju lutemi të kontaktoni – në varësi të rastit tuaj – ose **Shoqatën austriake të prindërve të shkollave të detyrueshme publike** (Tel.: 01/53120-3112; Celular: 0699/153 120 00; E-Mail: office@elternverein.at), ose për shoqatën e prindërve të të gjitha shkollave private katolike drejtoheni tek **Shoqata kryesore e shoqatës katolike të prindërve në Austri** (Tel.: 07224 4311; E-Mail: lvkev@mautnermarkhof.at).

Ne ju falënderojnë në avancë për mbështetjen tuaj!
Përsëritet me miqësori në emër të të gjithë grupit



Dr.^m Claudia Schreiner
Drejtorja BIFIE Salzburg



Mag.^a Simone Breit, Bakk. Komm.
Nëndrejtorja BIFIE Salzburg,
Drejtuuese e testimeve të standardeve arsimore